



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

### RAPORT VJETOR PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK PËR VITIN 2021 MINISTRIA E BUJQËSISË DHE E ZHVILLIMIT RURAL

**1.Përmbledhja ekzekutive** (pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)

Gjatë vitit 2021, Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural ka realizuar 100% planin e saj të konsultimit publik të akteve duke kryer procesin e konsultimit publik për aktet objekt i Ligjit Nr.146/2014 për “ Njoftimin dhe Konsultimin Publik “. MBZHR ka konsultuar 3 akte :

1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve”.
2. Projektvendim “Për zonat e përcaktuara për akuakulturë “
3. Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit”.


Nga monitorimi i platformës së Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) vihet re se për vitin 2021 ka patur 1182 vizitorë nga publiku. Situata e krijuar nga pandemia e COVID-19 ka ndikuar negativisht në pjesëmarrjen aktive të publikut në dhënien e kontributit për përmirësimin e projektligjeve. Ajo që identifikohet nga procesi i konsultimit i realizuar, edhe pse vihet re një përmirësim i këtij procesi gjatë kësaj periudhe, është nevoja për informim më të mirë të publikut dhe pjesëmarrje më aktive e tij. Kjo përbën një ndër sfidat për t'u adresuar edhe më mirë nga institucioni ynë.

## **2.Analiza e konsultimeve të kryera**

### ***2.1 Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike***

*2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?*

Për periudhën vjetore të vitit 2021 janë miratuar 16 akte, nga të cilat 3 akte janë objekt i Konsultimit Publik.



### 2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Janë konsultuar tre (3) akte, konkretisht: Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve", projektvendimi “Për zonat e përcaktuara për akuakulturë” të cilët kanë rëndësi strategjike dhe sipas pikës 1, të nenit 1 të ligjit “Për konsultimin Publik”, i nënshtrohet këtij procesi dhe Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit”.


Ndërkohë aktet e tjera të miratuara ndahen si më poshtë:

#### 1. 3 Projektligje

Një nga te cilat është marrëveshje ndërkombëtare, të cilat sipas shkronjës “b”, të Nenit 4, të Ligjit “Për konsultimin publik”, nuk i nënshtrohen këtij procesi;

## 2. 13 Projektvendime

të cilat sipas shkronjës “ç”, të Nenit 4, të Ligjit “Për konsultimin publik”, nuk i nënshtrohen këtij procesi duke përjashtuar projektvendimin “Për zonat e përcaktuara për akuakulturë “ i cili i është nënshtuar konsultimit për shkak të lidhjes së tij me dokumente strategjike .



### 2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Dy (2) ligje me raport VNR-je janë konsultuar të cilët janë Projektligji “ Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve “ dhe Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimt”.

### 2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Në PPAP e vitit 2021 janë parashikuar për miratim 22 projektakte (projektligje dhe projektvkm), nga të cilat për periudhën vjetore të këtij viti janë miratuar 16 akte ( 3 ligje dhe 13 VKM). Nga aktet e miratuara, janë përdorur kriteret e përjashtimit nga konsultimi publik:

- Për 1 projektligj, konkretisht Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 4/2016 “Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në lidhje me lehtësimin e mbështetjes së agrobiznesit - BERZH-Shqipëri, Llogari Bashkëpunimi”, në bazë të nenit 4 pika b) Mardhëniet ndërkombetare dhe marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe, përjashtohen në bazë bazë të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

- Për 12 projektvendime, në zbatim të shkronjës “ç”, të Nenit 4, të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Në PKIE e vitit 2021 janë parashikuar 10 akte. Për periudhën janar –dhjetor 2021 janë miratuar 5 projektakte: 1 VKM, 1 Udhëzim dhe 3 Urdhra Ministri, të cilat nuk i janë nënshtruar konsultimit publik në zbatim të shkronjës “ç”, të Nenit 4, të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

	Projektakte të parashikuara	Projektakte të publikuara për konsultim	Projektakte jo të publikuara për konsultim	% e akteve të publikuara për konsultim
a)PPAP	22	4	18	18%
b)PKIE (pwr vitin 2021)	10	2	8	20%
c) Dokumente strategjik të sektorit	-	-	-	-

#### 2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Janë konsultuar një (3) projektligje dhe një (1) projektvendim me rëndësi strategjike.

#### 2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Procesi i krahasuar me vitin e mëparshëm është përmirësuar, lidhur me diversifikimin e mjeteve të përdorura për konsultim, rritjen e aksesit të qytetarëve në konsultim dhe në shkallën e reaguesve të mbledhura.

### 2.2. Metodat e konsultimit

2.2.1. Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)

Metodat e përdorura për konsultimin publik gjatë kësaj periudhe ishin 3 (tre):

1. Konsultimi në faqen zyrtare të konsultimit publik,
2. Tryeza të konsultimit me ekspertë/grupe interesi
3. Komunikim nëpërmjet postës elektronike.

Të tre aktet e konsultuara i janë nënshtruar këtyre metodave të konsultimit .

### **Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”**

Forma e konsultimit është publikimi për Konsultim Publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike. Në përfundim të afatit të këtij konsultimi, gjithashtu, projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 105/2016 “Për mbrojtjen e bimëve”, së bashku me relacion shpjegues i është dërguar me email për komente dhe sugjerime Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve në UBT, shoqatës AFADA, Shoqatës së Mbrojtjes së Konsumatorit, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Agjencive Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve, Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor dhe Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

**Projektvendimi “Për zonat e përcaktuara për akuakulturë”** Forma e konsultimit ishte përmes Regjistrin Elektronik, RENJK. Krahas publikimit në këtë regjistër, ky projektvendim është konsultuar edhe me Shoqatën e Biznesit të Akuakulturës Vlorë, duke u dërguar një kopje të studimit. Nga ana e tyre nuk janë bërë komente por kanë kërkuar sqarime për të cilat u janë dhënë shpjegimet përkatëse. Projektvendimi është përgatitur nga ekspert shqiptar dhe të huaj. Puna është realizuar në kuadër të projektit “Mbështetje për sektorin e peshkimit në Shqipëri” (EuropeAid/155184/Act/AL) dhe posaçërisht nën Aktivitetin 1.10 – “Hartimi i planit mbi Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA) bazuar në udhëzimet dhe metodologjitë përkatëse”.

**Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit”** Forma e konsultimit ishte përmes Regjistrin Elektronik, RENJK, ku akti është rihedhur sërish për shkak se miratimi i tij është bërë në vitin 2021. Krahas publikimit në këtë regjistër, ky projektligj është konsultuar edhe me pushtetin vendor, Agjencinë e Zhvillimit Rajonal, Dhoma Rajonale e Tregtisë dhe Industrisë, Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural, Organizatat e Shoqërisë Civile; Shoqatat e Fermerëve; Shoqatat e Biznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës. Gjithashtu u komunikua dhe përmes postës elektronike.

#### *2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?*

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve ishte ajo e tryezave të konsultimit/takimeve dhe email ,ndërsa nga konsultimi publik nëpërmjet regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike nuk kishte asnjë koment.

#### *2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?*

Për të tre aktet e konsultuara janë realizuar konsultime paraprake specifikesht Projektvendimi “ Për zonat e përcaktuara për akuakulturë “ është përgatitur nga ekspert shqiptar dhe të huaj. Puna është realizuar në kuadër të projektit “Mbështetje për sektorin e peshkimit në Shqipëri” (EuropeAid/155184/Act/AL) dhe posaçërisht nën Aktivitetin 1.10 – “Hartimi i planit mbi Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA) bazuar në udhëzimet dhe metodologjitë përkatëse”.

Gjithashtu, për këtë projektvendim palët e interesit që kanë marrë pjesë në procesin e konsultimit publik ishin përfaqësues të Shoqatës së Akuakulturës në Vlorë. Ata u njoftuan me anë të postës elektronike ku dhe iu është dërguar materiali fillestar i dokumentit udhëzues.

### **2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve**

2.3.1. *Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?*

1. **Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve"**. U postua më datë 06.04.2020 dhe ka përfunduar më datë 02.05.2020.
2. **Projektligji "Për zonat e percaktuara për akuakulturë “**. U postua më date 20.01.2021 dhe ka përfunduar me datë 16.02.2021 .
3. **Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit”**. Kohëzgjatja e përgjithshme e konsultimeve është bërë nga periudha ka qenë nga data 16.5.2018 deri më 25.7.2018. U ripostua në RENJK më datë 22.11.2021 dhe ka përfunduar më datë 21.12.2021.

Konsultimet në RENJK për të gjitha projektligjet kanë qenë të hapura për 20 ditë, pra u realizua në përputhje me ligjin nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, përkatësisht me nenin 15 të tij.

2.3.2. *Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?*

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit për projektet e miratuara gjatë periudhës vjetore të vitit 2021, ishte 3 ( tre ) muaj.

### 2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Në krahasim me vitin e kaluar situata nuk ka pasur përmirësime të dukshme të procesit të konsultimit përmes RENJK, pasi interesi i publikut në procesin e konsultimit publik vijon të jetë ende i ulët. Megjithatë konsultimi përmes formave të tjera të konsultimit (takime online/postë elektronike) kanë lejuar pjesëmarrjen e më shumë aktorëve në proces dhe ka rezultuar më i vlefshëm.

## 2.4. Palët e interesuara të përfshira

### 2.4.1. Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Në hartimin dhe konsultimin e ligjeve të planifikuara për t'u konsultuar gjatë vitit 2021 kanë marrë pjesë 4 aktorë të jashtëm si : ekspertë të fushës, përfaqësues të institucioneve shtetërore, shoqata që operojnë në fushën e bujqësisë, përfaqësues të Universitetit Bujqësor, etj.

1. Projektvendimi “ Për zonat e përcaktuara për akuakulturë “ është përgatitur nga ekspert shqiptarë dhe të huaj. Puna është realizuar në kuadër të projektit “Mbështetje për sektorin e peshkimit në Shqipëri” (EuropeAid/155184/Act/AL) dhe posaçërisht nën Aktivitetin 1.10 – “Hartimi i planit mbi Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA) bazuar në udhëzimet dhe metodologjitë përkatëse”.

2. Projektligji “ Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit “, projektligji u hartua nga një grup pune ngritur me urdhër të ministrit për këtë qëllim një përfshirje të të gjithë institucioneve kontribuese: MBZHR, organizatat e shoqërisë civile, si dhe ekspertë ndërkombëtar dhe lokal, të siguruar me mbështetjen e Kooperacionit Italian.

### 2.4.2. Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

1. Struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës për Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve" ka qenë:
  - përfaqësues nga shoqatat që operojnë në fushën e bujqësisë;
  - përfaqësues nga Universiteti Bujqësor;
  - përfaqësues nga projektet që mbështesin sektorin e bujqësisë;
  - përfaqësues institucione të varësisë.

2. Struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës *Projekvendimi "Për zonat e percaktuara përakuakulturë"* ka qenë:
  - ekspert shqiptar dhe të huaj në fushën e peshkimit;
  - përfaqësues nga projektet që mbështesin sektorin e peshkimit;
  - përfaqësues institucione të varësisë.
  
3. Struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës për *Projektligjin "Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit"* ka qenë :
  - përfaqësues të pushtetit vendor
  - Agjencinë e Zhvillimit Rajonal
  - Dhoma Rajonale e Tregtisë dhe Industrisë
  - Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural
  - Organizatat e Shoqërisë Civile
  - Përfaqësues të Shoqatave të Fermerëve dhe Shoqatave të Biznesit
  - Përfaqësues nga Universiteti Bujqësor i Tiranës

2.4.3. *Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?*

Gjatë procesit të konsultimit për 3 aktet e konsultuara gjatë viti 2021, kanë marrë pjesë 9 palë të interesuara, nga të cilët dhënë komente/sugjerime me qëllim përmirësimin e projektligjeve.



2.4.4. Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Struktura e kontribuesve në konsultimet publike për të tre aktet :

1. Për Projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve":

- Universiteti Bujqësor i Tiranës;
- Shoqata që operojnë në fushën e bujqësisë;
- Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural;
- Shoqata e Mbrojtjes së Konsumatorit;
- Agjencive Rajonale të ekstensionit Bujqësor
- Shoqatës AFADA,

2. Për Projektligjin "Për zonat e percaktuara për akuakulturë "

- Komisionin Konsultativ Qendror për Peshkimin dhe Akuakulturën;
- Institucione të varësisë.
- Shoqata e Biznesit të Akuakulturës Vlorë

3. Për Projektligjin "Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit"

- Përfaqësues të pushtetit vendor
- Agjencinë e Zhvillimit Rajonal
- Dhoma Rajonale e Tregtisë dhe Industrisë
- Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural
- Organizatat e Shoqërisë Civile
- Shoqatat e Fermerëve
- Shoqatat e Biznesit
- Përfaqësues nga Universiteti Bujqësor i Tiranës

2.4.5. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara për vitin 2021 është në të njëjtat nivele.

## **2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra**

### *2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja përçdo konsultim?*

Në total numri i komenteve për të tre (3) aktet e konsultuara është 11 komente.

- Komentet dhe sugjerimet për aktet e konsultuara për vitin 2021 nuk ka patur konkretisht për projektligjin “ Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve" u janë kërkuar komente Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve në UBT, Shoqatës AFADA, Shoqatës së Mbrojtjes së Konsumatorit, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Agjencive Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve, Agjencive Rajonale të ekstensionit Bujqësor Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë nga të cilat është bërë vetëm një koment i cili është pasqyruar në projektligj.
- Për projektvendimin “ Për zonat e përcaktuara për akuakulturë ky projektvendim është konsultuar edhe me Shoqatën e Biznesit të Akuakulturës Vlorë, duke u dërguar një kopje të studimit. Nga ana e tyre nuk janë bërë komente por kanë kërkuar sqarime për të cilat u janë dhënë shpjegimet përkatëse.
- Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit” numri i komenteve të marra ka qënë i lartë.

### *2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?*

Për aktet e konsultuara gjatë vitit 2021, “ Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.105/2016, “Për mbrojtjes së bimëve” është marrë një (1) koment,” Për zonat e përcaktuara për akuakulturë “ nuk ka patur komente, projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit” ka patur 10 komente dhe u pranuan 6 prej tyre plotësisht.

- 7 komente janë pranuar plotësisht
- 4 janë pranuar pjesërisht
- 0 janë refuzuar

### 2.5.3. *Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?*

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara është në të njëjtat nivele.

### 2.5.4. *Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave tëmarra gjatë konsultimit publik?*

Nuk ka patur ndryshime/përditësime të VNR-së nga informacionet e marra gjatë konsultimit publik për dy aktet e konsultuara gjatë vitit të cilët kanë patur raport VNR-je konkretisht Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve” dhe Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit”

## **2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit**

### 2.6.1. *Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?*

Janë hartuar tre raporte konsultimi publik për aktet e konsultuara të cilat janë publikuar në Regjistrin Elektronik për njoftimet dhe Konsultimet Publike .

### 2.6.2. *Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?*

1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve” është konsultuar në vitin 2020, por procedurat për miratimin e tij nuk përfunduan në vitin 2020, prandaj është planifikuar në PPAP e vitit 2021. Projektligji është miratuar në KM në 22.06.2021 por nuk është rihedhur për konsultim publik pasi nuk ka ndryshime përmbajtësore.

<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/263>

2. *Projektvendim “Për zonat e përcaktuara për akuakulturë “*

<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/320>

3. Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit”. Procedurat për miratimin e tij përfunduan në vitin 2021, prandaj është rihedhur për konsultim publik në regjistër por ligji nuk ka patur ndryshime thelbësore ligjore në përmbajtje të tij.

<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/429>

**2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik** *(Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)*

1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve". 8
2. Projektvendim “Për zonat e përcaktuara për akuakulturë “ 8
3. Projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit” 8

**3.Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen**

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik lidhen më së shumti me gjithëpërshirjen e publikut në këtë proces. Ende nuk reflektohet një kulturë e angazhimit në proceset e hartimit të politikave. Megjithë përjekjet dhe mundësitë e ofruara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ende nuk ka përfshirje aktive të publikut në procesin e dhënies së rekomandimeve apo qëndrimeve për përmbajtjen e projektakteve që hartohen. Për periudhën e ardhshme, me qëllim përmirësimit të procesit, organizimi i konsultimeve është planifikuar të orientohet edhe më shumë përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik. Mendojmë se për të përmirësuar procesin e konsultimit publik dhe për të siguruar një përfshirje sa më të madhe të publikut në këtë proces, është e nevojshme dhe zhvillimi i trajnimeve mbi procesin e konsultimit publik për të gjithë punonjësit që merren me hartim legjislativ. Kjo do të mundësonte një njohje dhe përdorim edhe më të mirë e të shtuar të metodave gjatë procesit të konsultimit publik dhe rritjen e pjesëmarrjes së publikut në konsultimin e projektakteve.